

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: kryetare e kolegjit Tonka Berishaj, gjyqtari Fillim Skoro, referues dhe Have Haliti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Suzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.M., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së PDTH-DKR në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prizren P.nr.24/2018 me dt.20.07.2018,ne seancën e kolegjit me dt 26.11.2018. mori këtë:

## AKTGJYKIM

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e PTH-DKR ne Prizren dhe e te akuzuarit H.M. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, P.nr.24/2018, të dt.20.07.2018 vërtetohet.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore- DKR në Prizren, PKR.nr.24/2018,të dt. 20.07.2018, i akuzuari H.M. është shpallur fajtorë për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne afatin prej 1(një) viti i akuzuari nga dita e plotfuqishmërisë nuk kryen vepër te re penale.

I dëmtuari N.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

I akuzuari është obliguar që te paguaj paushallin gjyqësore në shumën prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro, i cili është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë aknes kanë ushtruar

Prokuroria Themelore DKR në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Prizren ta ndryshojë dhe të akuzuarit të ja shqiptojë një dënim më të ashpër me burgim për veprën penale të kryer.

I akuzuari H.M. ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes se ligjit penal, vërtetimit te gabuar dhe jo të plotë te gjendjes faktike, dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ne mungesë të provave të akuzuarin, ta liroj nga akuza ose çështjen penale ta kthejë ne rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit DKR në Prishtinë me shkresën e saj P.nr.24/2018 të dt.20.07.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit H.M. të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa të aprovohet ankesa

e PTH-DKR në Prizren, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim me burgë efektiv më i ashpër.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPP nuk ka caktuar seancë të kolegjit ngase nuk kemi të bëjmë me burgim efektiv dhe pjesëmarrja nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, sipas ankesave të Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren dhe të akuzuarit, edhe sipas detyrës zyrtare, duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas shqyrtimit dhe vlerësimit, të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesat e PTH-DKR ne Prizren dhe të akuzuarit refuzohen si të pa bazuara

Pretendimet Ankimore dhe gjetjet e Gjykatës:

Prokuroria Themelore DKR ne Prizren ne ankesën e saj pretendon se dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje prej 5 (muajve) nëse i akuzuari ne afatin e verifikimit prej një viti nuk kryen veprë të re penale, është në shpërpushje me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë, dhe se për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 442 par1 të KPRK-së është paraparë dënimi prej 6 muajve deri në 5 vite dhe gjykata nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi matjen e dënimit të parapare si ne nenin 74,75,dhe 76, sepse nuk ka ekzistuar ndonjë rrethane përpos rrethane lehtësuese që do të arsyetonte dënimin me kusht ndaj të akuzuarit. Dënimi i shqiptuar dhe i kushtëzuar, është dënim simbolik dhe nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, dhe dënimi i shqiptuar nuk është ne përputhje me KPRK.

I akuzuari, edhe pse aktgjykimin e sulmon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale ,shkeljes se ligjit penal, në ankesë kryesisht bëhet fjalë për vërtetimin e gabuar dhe jo të potë të gjendjes faktike, e sipas ankesës aktgjykimi nuk është bindës, dhe nuk mbështetet në asnjë provë, i akuzuari pretendon se nuk e ka njohur dhe nuk ka patur asnjë kontakt të çfarëdoshëm me të dyshimtin M.P. e as të dëmtuarin N.B. dhe nuk ka pasur asnjë motiv që ta ndihmoj njërin apo ta dëmtoj tjetrin, i akuzuari ne natën kritike deklaroi se policët derisa ishin në pikë të kontrollit në fshatin ..., kanë ndaluar një person që bartte çimenton me kamionet, i kanë marrë hetimet dhe e kanë liruar. Më vonë ne stacionin policore të Suharekës përmes një telefonate është lajmëruar një vjedhje e çimentos në fshatin ... , dhe i akuzuari H.M. si shef i ndërrimit i ka kontaktuar policët që të shkonin ne fshatin ... ku është lajmëruar vjedhja .I akuzuari pretendon se i ka ndërmarrë të gjitha veprimet që nuk ka pasur kompetence ka pyetur prokurorin kujdestarë të departamentit të përgjithshëm dhe ka vepruar sipas udhëzimeve të tij. I akuzuari pretendon se gjykata ka vlerësuar gabimisht gjendjen faktike dhe mungesën e provave që është dashur të sjellë Prokuroria, i ka interpretuar ne dëm të akuzuarit, dhe ne shkelje të ligjit penal dhe procedurës penale ka marrë vendim të gabuar, prandaj nga se u tha me lartë dhe në përgjithësi në këtë shkresë kërkoj nga Gjykata e Apelit të më lirojë nga akuza ose rastin ta kthejë ne rigjykim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesa, e vlerësoj aktgjykimin edhe sipas bazës ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilën

shikon gjykata sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 384 par.1 të KPP-së. dhe gjen se aktgjykimi i ankimuar, është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 365.par. 1 të KPP-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe si i tillë është koherent me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit. Arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, përmban arsye të plota dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit se i akuzuari H.M. është kryes i veprës penale keqpërdorim i autoritetit apo detyrës zyrtare kjo mbështetet në provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, se i akuzuari H.M. nuk e ka ndaluar gjatë kontrollit kombin të cilin e ka drejtuar M.P. në të cilin kanë qene 39 thasë çimento të ngarkuar e të cilat ishin vjedhur në shtëpinë e N.B.t, e këtë fakt vendimtar e vërteton edhe vet i dëmtuari N.B. se çimentoja ishte vjedhur në shtëpinë e tij, ndërsa i akuzuari H.M. nuk ka ndërmarr veprimet e tija ligjore për të ndaluar M.P. dhe të sekuestroj çimenton e cila ishte vjedhur, këto fakte mbështeten edhe nga zyra ligjore e operatorit të telefonisë mobile "Vala" në Prishtinë, nga e cila vërtetohet se i akuzuari H.M. nuk ka zhvilluar ndonjë bisedë me Prokurorin kujdestarë dhe një e dhënë e tillë nuk është në sistemin e operatorit "Vala", e të njëjtat fakte i vërtetojnë edhe dëshmitarët-Policët I.I., B.B. të cilët kanë qene në pike kontrollin në fshatin ... dhe ata kanë ndaluar M.P.n dhe aty kanë vërtetuar se i akuzuari H.M. nuk e kishte ndaluar M.P. i cili në kombin e tij i kishte të ngarkuara 39 thasë çimento e të cilat ishin vjedhur në shtëpinë e N.B.t, dhe gjykata ka nxjerrë përfundime të drejta dhe të qarta, e të bazuara në faktet dhe provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë. Nga kjo rezulton se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë nga ana e të akuzuarit nuk qëndrojnë, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë është e pa bazuar, dhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se i akuzuari H.M. është person zyrtar-Rreshter i Policisë ,dhe në cilësinë e personit zyrtar të policit nuk e ka ndaluar kombin ku kanë qenë të ngarkuar 39 thasë çimento të cilat ishin vjedhur në oborrin e shtëpisë të dëmtuarit N.B., dhe në këtë mënyrë nuk i ka përmbush detyrat e tij zyrtare të cilat është dashur ti kryej, me ndaljen e M.P. dhe sekuestrimin e çimentos. Gjykata drejt ka vërtetuar se i akuzuari H.M. në cilësinë e personit zyrtar e duke mos i përmbush detyrat e tija zyrtare i ka mundësuar M.P. të përfitojë dobi pasurore prej 39 thasëve çimento e në vlerë prej 156 euro dhe gjykata në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për gjykatën e apelit.

Pretendimet ankimore të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të tij nuk qëndrojnë, kjo për arsye se i akuzuari ka keqpërdorur pozitën dhe autoritetin e tij zyrtar me mos përmbushjen e detyrave të tija zyrtare-si person zyrtar, Rreshter i Policisë e të cilat detyra është dashur që ti kryej, dhe i akuzuari H.M. me dt 06.05.2016, në pikën e kontrollit, nuk e ka ndalë M.P.n dhe nuk ka sekuestruar çimenton e vjedhur, prej 39 thasëve të ngarkuara në kombin e tij e të cilët ishin vjedhur në oborrin e shtëpisë të dëmtuarit N.B., e duke keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar me tejkallimin me mos përmbushjen e detyrave të tija zyrtare, i shkakton dëm material në shumë prej 156 E të dëmtuarit N.B. e nga kjo dele se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal nga neni 385 par. 1 të KPP-së, ndërsa, ankesa e të akuzuarit është e pabazuar, për arsye se veprimet të cilat i ka ndërmarrë këtu i akuzuari në cilësinë e policit- Rreshter i Policisë, janë jo ligjore dhe në kundërshtim me kompetencat e tija ligjore të përcaktuara me ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin të PTH-DKR në Prizren, dhe të akuzuarit janë të pa bazuara dhe gjykata dënimin e shqiptuar në kohëzgjatje prej 5 muajve nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej një viti nuk kryen veprë të re penale, dënimi i këtillë është shqiptuar duke marrë parasysh rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit të paraparë si në nenin 73 par .1 të KPRK –së, dhe dënimi është zbutur duke u bazuar në dispozitën e nenit 50 të KPRK-së dhe pretendimet ankimore të cekura në të dy ankesat dhe nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat rënduese dhe lehtësuese nga gjykata nuk qëndrojnë. Gjykata e Apelit rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë i merr si të vërtetuara, dhe drejt janë vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese e në kuadër të rregullave mbi matjen e dënimit të paraparë si në nenin 74 dhe 51 të KPRK-së dhe dënimi i shqiptuar merret në kohëzgjatje prej 5 (muajve) nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej një viti nuk kryen veprë të re penale është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata e Apelit, i ka marrë si të vërtetuara rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, si sjelljet e mira të akuzuarit, se i njëjti është familjar, baba i dy fëmijëve, se më parë nuk ka qenë i dënuar, gjë që tregon se jeta e tij e mëparshme ka qenë në harmoni me dispozitat pozitive ligjore, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dënimi i shqiptuar dhe i kushtëzuar nga gjykata e shkallës së parë, është shqiptuar me vlerësimin e të gjitha rrethanave të cekura më lartë, dhe me këtë dënim të shqiptuar pritët, që i akuzuari në të ardhmen të mos kryejë vepra penale të këtilla, si dhe të bëhet rehabilitimi i tij, e njëkohësisht ky dënim i shqiptuar të ndikojë edhe të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritët qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Si u cek edhe më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që ankesat e PTH DKR në Prizren dhe të akuzuarit janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar është vërtetuar e në bazë të nenit 401 të KPP-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.508/2018, me dt. 26.11.2018**

**Procesmbajtësi,**

Suzana Goxhuli

**Anëtarët e Kolegjit,**

Fillim Skoro

Have Haliti

**Kryetare e Kolegjit,**

Tonka Berishaj